

VENDIM
Nr. 598, datë 5.9.2007

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE TË
NDËRMARRJES SHTETËRORE “SHTYPSHKRONJA E BANKËS SË SHQIPËRISË”**

(Ndryshuar me VKM nr. 862, datë 18.6.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ndërmarrjes shtetërore “Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë”, në varësi administrative të Bankës së Shqipërisë.

2. Punonjësit, që dalin të papunë nga mbyllja e kësaj ndërmarrjeje, të trajtohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

3. Banka e Shqipërisë, si institucion përgjegjës, të bëjë likuidimin e shumave të pagesave përkatëse, në bazë të listëpagesave, të paraqitura në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Periudha gjatë së cilës punonjësit e kësaj ndërmarrjeje do të marrin pagesën e përcaktuar në këtë vendim, të njihet si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti dhe familjar, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Pas mbarimit të trajtimit, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, punonjësit të trajtohen me pagesë papunësie, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Detyrimet kontabile, që ndërmarrja shtetërore “Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë” ka ndaj të tretëve, deri në çastin e mbylljes së veprimtarisë, të përballohen nga vetë ndërmarrja.

6. Detyrimet kontabile, që të tretët kanë ndaj kësaj ndërmarrjeje, deri në çastin e mbylljes së veprimtarisë, të ndiqen për t’u arkëtuar nga Ministria e Financave. Fondet e arkëtuara derdhen në Buxhetin e Shtetit.

7. Ngarkohet Banka e Shqipërisë, që në përputhje me vendimin nr.153, datë 3.4.1993 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, të kryejë transferimin e kapitaleve të patrupëzuara dhe inventarin ekonomik të mjeteve të xhiros së kësaj ndërmarrjeje, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përgjegjësi të Ministrisë së Financave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve t’i transferohen teknologjia dhe të gjitha makineritë e shtypshkronjës, për shtypjen e pullave fiskale.

9. Ngarkohet Ministria e Financave për shitjen, nëpërmjet ankandit të hapur, të kapitaleve të patrupëzuara të ndërmarrjes. Të ardhurat e realizuara nga kjo shitje t’i kalojnë Buxhetit të Shtetit.

10. Përgjegjësia e administrimit të ndërtesës, ku zhvillon veprimtarinë ndërmarrja shtetërore “Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë” i mbetet Bankës së Shqipërisë, sipas vendimit nr. 762, datë 13.11.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Bankës së Shqipërisë”.

11. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 30 shtator 2008.

KRYEMINISTRI

ANEKSI 1
 BANKA E SHQIPËRISË
 NDËRMARRJA SHTETËRORE “SHTYPSHKRONJA E BANKËS SË SHQIPËRISË
 TABELA E EFEKTEVE FINANCIARE PER PAGA+SIGURIME SHOQËRORE
 PERIUDHA 1-VJEÇARE

Nr.	Emri Mbiemri	Vite në ndërmarrje	Paga mujore	Paga vjetore	Sigurime shoqërore	Sig. 1- vjeçar	Totali sig.+pagë	Totali sig.+pagë
1	Alfons Theka	18	154000	1848000	20231	242772	2090772	2090772
2	Lumturi Balla	13	104120	1249440	20231	242772	1492212	1492212
3	Saryhan Merdani	12	112480	1349760	20231	242772	1592532	1592532
4	Vjollca Bastari	17	42000	504000	12933	155196	659196	659196
5	Margarita Shyti	17	36000	432000	11085	133020	565020	565020
6	Aleksandër Qirjazi	15	33000	396000	10162	121944	517944	517944
7	Reshit Hoxha	7	33000	396000	10162	121944	517944	517944
8	Beqir Yrsheku	11	36000	432000	11085	133020	565020	565020
9	Vjollca Kallushi	8	40000	480000	12317	147804	627804	627804
10	Afërdita Goga	25	40000	480000	12317	147804	627804	627804
11	Ejup Baftjari	17	40000	480000	12317	147804	627804	627804
12	Vjollca Dobi	25	33000	396000	10162	121944	517944	517944
13	Fidarije Dervishi	16	33000	396000	10162	121944	517944	517944
14	Flutura Selimi	17	36000	432000	11085	133020	565020	565020
15	Mereme Teta	25	23000	276000	7082	84984	360984	360984
16	Donika Hoxha	25	30000	360000	9238	110856	470856	470856
17	Frida Shala	15	30000	360000	9238	110856	470856	470856
18	Nadire Doda	5	30000	360000	9238	110856	470856	470856
19	Liljana Rasha	4	30000	360000	9238	110856	470856	470856
20	Irma Allmeta	4	30000	360000	9238	110856	470856	470856
21	Ferdide Caka	4	30000	360000	9238	110856	470856	470856
22	Mimoza Rexhmati	12	30000	360000	9238	110856	470856	470856
	Shuma		1005600	12067200	256228	3074736	15141936	15141936

ANEKSI 2

Bilanci i ndërmarrjes shtetërore "Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë" në datën 31 Mars 2007			
1. Godina/troje	5,365,290.28	1. Kapitali dhe rezervat	217,987,355.35
Ndertime/rikonstruksione	17,055,811.00	Kapitali i nenshkruar	51,516,720.25
Amortizime	-11,690,520.72	Fitime neto, te mbartura	167,890,915.55
		Humbje te perealizuara (virtuale)	-1,420,280.45
2. Aktive te tjera te qendrueshme	5,795,419.22	Transferim i vleres se godines prane B.SH	-5,365,290.28
Instalime teknike, makineri,pajisje	79,129,402.84		
Amortizime	-74,094,946.33	1. Kapitali dhe rezervat pa vleren e godines	212,622,065.07
Mjete transporti	3,216,172.40		
Amortizime	-3,216,172.40		
Paisje zyre/informatike/mobilje/orendi etj	2,965,458.00		
Amortizime	-2,204,495.29		
3. Aktive qarkulluese/inventare	24,720,268.63	2. Fonde te tjera te vetat	48,938,219.81
materiale te para dhe materiale		Fondi i zhvillimit	24,166,367.60
ndihmese	21,565,145.15	Fondi i shperblimit suplementar te punonjesve	141,331.00
produkte te gatshme dhe te ndermjetme	451,994.89	Fondi i ndihmave te menjehereshme	5,406,365.00
gjendje inventari/te tjera	973,356.35	Fonde te tjera	19,224,156.21
Kliente per shitje, sherbime	1,729,772.24		
4. Likuiditete dhe vlera arke	231,645,155.03	3. Detyrime afatshkurtra	600,558.00
Depozita ne banke dhe ne llogari te tjera	231,639,058.03	Furnitore per blerje e sherbime	260,000.00
Para ne dore (arka)	6,097.00	Sigurime shoqerore dhe te ngjashme	283,185.00
		Shteti-tatime dhe taksa	57,373.00
Totali aktiveve (pa godinen)	262,160,842.88	Totali Kapitalit dhe detyrimeve (pa godinen)	262,160,842.88
Totali aktiveve (me godinen)	267,526,133.16	Totali Kapitalit dhe detyrimeve	267,526,133.16